

KUSHTET E GARANCISË

Periudha e Garancisë fillon nga data e blerjes dhe përfundon në afatin e shprehur në Fletën e Garancisë.

Përpara instalimit dhe përdorimit të produktit që keni blerë, lexoni me kujdes manualin/udhëzimet e prodhuesit dhe më pas veproni në përputhje me rregullat e përcaktuara. Ruani paketimin origjinal derisa të siguroheni që pajisja që keni blerë funksionon në rregull.

ÇFARË MBULON KJO GARANCI?

Garancia mbulon riparimin (kthimin në gjendje pune) falas të produkteve të shitura nga ITD Shpk, duke plotësuar njëherësh të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Defekti i produktit është me origjinë prodhim/fabrikimi.
- Produkti reklamohet pranë qendrës së servisit brenda Periudhës së Garancisë.
- Produkti shoqërohet me Faturën e blerjes dhe Fletën e Garancisë.
- Produkti nuk është hapur (ndërhyrje teknike) nga persona të pa autorizuar me shkrim nga ITD Shpk.

Shërbimi i garancisë do të kryhet në ambientet e servisit të ITD Shpk, në adresat e shënuara më poshtë.

Shërbimi i garancisë mund të kryhet edhe në ambientet e Klientit (nëse kërkohet nga klienti) kundrejt pagesës të *Tarifës së Shërbimit tek Klienti*.

Shërbimi i kryer gjatë kohës së garancisë (riparim apo zëvendësim) nuk do të sjellë shtyrje të periudhës së kësaj garancie.

KUR APLIKOHET SHËRBIMI ONSITE I GARANCISË?

- Aplikohet vetëm për produktet e ofruara me shërbimin Onsite.
- Dërgimi i specialistit në adresën e klientit për këtë kategori shërbimi, nuk do të thotë që pajisja do të trajtohet patjetër në garanci:
 - Nëse pajisja i plotëson kushtet standarde të pranimit në garanci, ajo do të trajtohet në garanci pa asnjë shpenzim.
 - Nëse pajisja nuk i plotëson kushtet e trajtimit në garanci, klienti do të paguajë tarifën e shërbimit onsite sipas Tarifave të Shërbimit tek Klienti që aplikon kompania.
- Klienti duhet t'i mundësojë specialistit hapësirën dhe kushtet e nevojshme për të kryer shërbimin onsite.

PËRGJEGJËSIA JUAJ!

- Sigurohuni që të keni bërë backup të të dhënave në kompjuterin tuaj. Servisi nuk mban përgjegjësi për humbjen e të dhënave tuaja.
- Nëse produkti i blerë është me funksionin TPM, duhet të ruani chip/passwordin.
- Hiqini passwordin pajisjes së sjellë në servis ose pajisni punonjës in e qendrës së servisit me passwordin përkatës.
- Përpara dorëzimit në qendrën e servisit, sigurohuni që produktit t'i keni hequr: flash/pendrive, cd/dvd, memory card. Servisi nuk mban përgjegjësi për humbjen e tyre.

ÇFARË NUK MBULON KJO GARANCI?

- Pajisjet/produktet të cilave u është dëmtuar/hequr/fshirë Numri Serial.
- Pjesët e konsumueshme të produkteve Printer, Fotokopje, etj (toner/bojë, zhvillues, cilindër, etj).
- Software/ Programet (dëmtimi/fshirja/humbja e tyre).
- Dëmtimet fizike aksidentale, nga abuzimi, keqpërdorimi, pakujdesia ose transportimi i papërshtatshëm.
- Dëmtimet nga viruset.
- Dëmtimet/ defektet e shkaktuara nga:
 - Mosrespektimi i instruksioneve të instalimit të produktit dhe përdorimit të tij.
 - Tjetërsimi i funksionalitetit apo keqpërdorimi i kapaciteteve të produktit.
 - Përdorimi i produktit në ambiente të papërshtatshme (pluhur, lagështirë, dridhje, nxehtësi, fusha magnetike, etj).
 - Materiale të lëngshme (ujë, etj), zjarri, shkaqe natyrore apo vjedhje.
 - Mbitensioni elektrik ose puna me tension jashtë kufijve 230 +/- 15% dhe të përcaktuara në manualin e produktit.
- Nëse produktit i janë kryer shërbime apo instalime nga persona të pa autorizuar me shkrim nga ITD Shpk.
- Defektet e shkaktuara mbi produktin për shkak të lidhjes së tij me produkte të tjera, jo të blera ose të instaluar nga ITD Shpk, dhe jo kompatibël me produktin.
- Problemet dhe keqfunksionimet e pajisjes të shkaktuara nga përdorimi i konsumable-ve jo origjinale.
- Ekranet e monitorëve, Notebook-ve apo AIO-ve nëse kanë pika (pixel) defektoze, më pak se 3 bright pixel ose më pak se 5 dark pixel.
- Llambat e projektorëve pas afatit kohor prej 90 ditësh nga blerja ose 500 orë pune (ajo që arrihet e para).
- Baterinë e Notebook pas afatit kohor prej 1 viti nga blerja.
- Dëmtimet e plota/pjesshme të programeve apo informacioneve për shkak të defekteve të produktit.
- Dëmet te cilat mund t'i shkaktohen klientit apo palëve të treta në aktivitetin e tyre, nga mosfunksionimi i produktit. Kjo është e vlefshme edhe kur ky mosfunksionim është për shkak të defekteve që mbulohen nga garancia.

Adresa e servisit 1:

Rr. "Dervish Hima" mbrapa stadiumit "Qemal Stafa", Tiranë. Tel: 044504129; Cel: 0692099389.

Adresa e servisit 2:

Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 1. Cel: 0694072863.